

EUGENIO BUCCIOL: "ALBANIA: FRONTE DIMENTICATO DELLA GRANDE GUERRA", "Nuovadimensione", Venezia, 2001, 156 f.

Shqipëria dhe historia e saj janë duke tërhequr vëmendjen e një numri gjithnjë e më të madh historianësh e studiuesish të huaj. Duke studiuar aspekte të ndryshme të historisë shqiptare, këta studiues janë duke plotësuar kuadrin e larmishëm të historisë sonë, duke dhënë kështu një ndihmesë të veçantë në lëmin e albanologjisë. Një nga këta studiues është edhe Eugenio Bucciol, një studiues italian i Luftës së Parë Botërore, i cili i është paraqitur lexuesit me librin e tij "Albania: Fronte dimenticato della Grande Guerra" ("Shqipëria: Fronti i humbur i Luftës së Madhe"). Bucciol ka bërë një punë të lavdërueshme dhe mjaft të dobishme për studimin e historisë së Shqipërisë gjatë Luftës I Botërore.

Në fokusin e librit "Shqipëria: Fronti i humbur i Luftës së Madhe", është paraqitja e Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore me materiale fotografike nga arkivat austriake. Libri ka 156 faqe dhe është botuar në Venecia të Italisë në vitin 2001 nga shtëpia botuese "Nuovadimensione". Libri është i ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë, e hartuar nga studiuesja Marina Rossi, paraqet një histori të shkurtër të Shqipërisë dhe të shqiptarëve nga lashtësia deri në fund të Luftës së Madhe. Duke qenë se objekti i këtij libri është Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore, atëherë një vend të posaçëm zë edhe paraqitja e rëndësisë strategjike si dhe zhvillimet ushtarake në Shqipëri gjatë kësaj lufte. Por meqenëse autorja i sheh zhvillimet e Luftës së Madhe si vazhdim të luftërave ballkanike, ajo i kushton paraprakisht një vend të posaçëm edhe këtyre të fundit. Sipas saj, ky varg luftërash që tronditën Evropën dhe në mënyrë të veçantë Ballkanin ishte produkt i prishjes së ekuilibrave të forcës mes fuqive të mëdha. Në këtë kuadër, ajo nënvizon gjithashtu se pavarësia e Shqipërisë ishte produkt i këtyre luftërave dhe se shteti shqiptar u krijua fal ndërhyrjes austro-hungareze dhe italiane, interesat strategjike të të cilave, pas shpartallimit të Turqisë nga aleatët ballkanik, ecnin në kahe të

kundërt me interesat e fqinjëve të Shqipërisë dhe në të njëjtin kah me aspiratën e shqiptarëve për të krijuar një shtet të tyrin kombëtar.

Për sa i përket veprimeve ushtarake gjatë Luftës së Madhe, studiuesja Rossi i ka kushtuar një pjesë të veçantë edhe tërheqjes tragjike të ushtrisë serbe nëpër Shqipëri në dimrin e vitit 1915. Në fund të pjesës së parë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur edhe një varg kujtimesh nga ushtarë austro-hungarez që morën pjesë në luftimet kundër serbëve, apo që kryen shërbimin ushtarak në Shqipëri. Në këtë mënyrë, nëpërmjet kësaj pjese hyrëse lexuesi arrin të krijojë një ide të përgjithshme për kompleksitetin e gjendjes në Shqipëri dhe rajon, në prag dhe më pas gjatë Luftës së Madhe.

Në pjesën e dytë të librit është paraqitur koleksioni fotografik, i cili është ndarë nga autori në disa seksione. Autori e sheh çështjen shqiptare të lidhur me rajonin dhe me çështjet kombëtare të vendeve që bëjnë pjesë në të. Për këtë arsye ai e integron dhe e shkrin në një çështje të vetme, çështjen maqedonase, çështjen shqiptare dhe themelimin e shtetit të pavarur shqiptar, luftërat ballkanike dhe më pas zhvillimet e Luftës së Madhe. Si rrjedhim, ai e nis këtë koleksion me disa fotografi nga kryengritja maqedonase e vitit 1903, ku paraqiten disa prej çetave të nacionalistëve sllavë të këtyre trevave. Më pas ky seksion vazhdon me një varg fotografish ku paraqiten pamje mjaft interesante nga luftërat ballkanike, ku një vend të posaçëm zënë fotografitë në të cilat tregohen marrëdhëniet mes ushtarëve të palëve ndërluftuese, mes robërve dhe fitimtarëve.

Seksioni pasardhës i koleksionit fotografik i është kushtuar qeverisjes së Princ Vidit. Në këtë seksion ka disa fotografi me mjaft interes, ku përveç fotografisë së çiftit princëror Vid, paraqitet një fotografi e delegacionit shqiptar, i cili i ngarkuar në karroca, i është drejtuar kështjellës së Noividit, ku do t'i paraqesë Vilhelm Vidit kurorën shqiptare. Autorit i është dukur me rëndësi të paraqesë edhe fotografinë e Esat pashë Toptanit dhe të rezidencës së tij.

Seksioni tjetër i koleksionit paraqet fotografi me mjaft vlerë, në të cilat është përjetësuar tërheqja tragjike e ushtrisë së mundur serbe në dimrin e vitit 1915, nëpërmjet maleve të Shqipërisë së Veriut. Këto fotografi kanë një vlerë shumë të madhe historike, dhe ndër to bie në sy fotografia ku paraqitet mbreti serb, Pjetri, i hipur në një karrocë të tërhequr prej qesh, simbol ky i disfatës së tmerrshme që kishin pësuar

ushtritë serbe nën goditjen e ushtrive të Qendrës. Koleksioni fotografik është i shoqëruar edhe me kujtime të pjesëmarrësve në këto ngjarje.

Seksioni pasardhës i koleksionit paraqet fotografi në të cilat janë mbërthyer imazhe nga zona e pushtimit austro-hungarez në Shqipëri. Edhe në këtë seksion ka fotografi që paraqesin mjaft interes, dhe ato mund të shihen si dokumente të vërtetë historik. Në to jepen pamje nga veprimtaria e përditshme e ushtrisë së mbretërisë së dyfishtë. Kjo veprimtari shtrihet që nga ndërtimi, te higjienizimi i qyteteve shqiptare, e deri te lufta kundër bandave dhe hajdutëve shqiptarë. Gjithashtu në këtë koleksion paraqiten edhe fotografi, të cilat dëshmojnë jetën shqiptare të asaj periudhe, si dhe fotografi të grupeve shqiptare që iu bashkuan ushtrisë së monarkisë Habsburgase. Shpesh fotografitë shoqërohen edhe me kujtime mbi Shqipërinë dhe shqiptarët të përfaqësuesve ushtarak austro-hungarez në Shqipëri. Është për t'u vënë në dukje se këto kujtime kanë një vlerë të madhe, pasi ato paraqesin nivelin tejet primitiv të shoqërisë shqiptare. Nga to del hapur ballafaqimi dramatik i perëndimorëve me këtë shoqëri të prapambetur, të varfër e plot ngjyra.

Seksioni tjetër i koleksionit paraqet një varg fotografish nga zona e pushtimit italian. Përmbajtja e këtij seksioni është e njëjtë me atë të seksionit që flet për zonën e pushtimit austro-hungarez. Fotografitë e këtij seksioni në pjesën më të madhe të tyre janë të përqendruara në qytetin e Vlorës. Seksioni i fundit i pjesës së dytë të librit përmban disa fotografi nga fronti maqedonas ku vepruan nga ana e Antantës trupat e Armatës së Lindjes, dhe nga ana e Boshtit trupat bullgare-gjermane-turke.

Pjesa e tretë e librit i është kushtuar Bllokadës së Otrantos, e cila u vendos prej flotave ushtarake të shteteve të bllokut të Antantës kundër nëndetëseve austro-hungareze dhe atyre gjermane, të cilat duke përdorur bazat shumë të mbrojtura të Dalmacisë dhe Malit të Zi dëmtonin rëndë karvanet e flotës tregtare të vendeve të Antantës në Mesdhe. Këto goditje kundër flotave tregtare britanike, franceze dhe italiane nuk dëmtonin vetëm ekonomikisht këto fuqi, por edhe ushtarakisht, pasi flotat e tyre tregtare furnizonin me trupa dhe armatime Armatën e Lindjes në Ballkan.

Përfshirja në këtë libër e luftës detare të zhvilluar në Adriatik nuk është e rastësishme. Në fakt, për nga vetë pozita gjeografike, zotërimi i bregut shqiptar luante një rol të dorës së parë në këtë luftë. Kështu edhe pushtimi i Shqipërisë dhe ndarja e saj në zona të ndryshme pushtimi nga fuqitë e të dyja blloqeve kundërshtarë është pjesë e një skenari më të gjerë të betejave që u zhvilluan gjatë luftës së përbotshme në siudhësën e

Ballkanit. Autori paraprakisht shpjegon zhvillimet e luftës detare në Adriatik, fazat nëpër të cilat ajo kaloi, si dhe taktikat ushtarake që u përdorën prej palëve. Gjithashtu, autori shtjellon edhe disa prej përplasjeve më domethënëse mes flotës austro-hungareze dhe asaj anglo-italiane në Adriatik, si dhe disa prej aksioneve më të shkëlqyera nga marinarët e të dyja palëve. Koleksioni i fotografive të këtij seksioni jep imazhe të porteve kryesor ku ishin përqendruar flotat e të dy blloqeve, si dhe fotografi të njësisve detare si të sipërfaqes, ashtu edhe atyre të nën ujit. Sikurse edhe në seksionet e tjera, fotografitë shoqërohen me komente ose shpjegime mbi vetë fotografitë, mbi veprimtarinë e kryer prej subjekteve apo personazheve të paraqitura në fotografi.

Ky libër paraqet një nismë mjaft të vlefshme për studimin e Historisë së Shqipërisë, pasi nëpërmjet fotografive na e bën më të prekshme situatën dhe zhvillimet e kohës. Gjithashtu, këto fotografi janë një burim i çmuar edhe për studimin e historisë dhe shoqërisë shqiptare të kohës, pasi në to paraqitet më së miri ambienti shqiptar. Në fakt, pasi sheh këto fotografi jo vetëm të krijohet një pamje më e qartë për Shqipërinë e asaj periudhe, por më pas arrin të rrokësh më mirë zhvillimet historike të kohës, pasi kupton dhe njeh më mirë mjedisin ku këto zhvillime morën jetë. Një veçori tjetër për t'u përhëndetur e këtij libri është edhe fakti se autori pavarësisht se ka për objekt studimi Shqipërinë, ai nuk e merr objektin e punës së vet të izoluar nga ngjarjet e kohës. Pra, ai nuk e sheh Historinë e Shqipërisë dhe vetë Shqipërinë të izoluar nga ajo çka ndodhte në rajon e më gjerë. Përkundrazi, historia e vendit tonë, që nga momenti i shkëputjes nga sundimi osman, fitores së pavarësinë dhe hyrjes së tij në familjen e shteteve evropiane, ka qenë e integruar dhe e përfshirë në të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur në kontinent e veçanërisht në Ballkan.

Është e kuptueshme se përveç anëve pozitive ky libër do të kishte edhe disa pika të dobëta. Studiuesja Rosi, kur bën historikun e shkurtër të shqiptarëve nuk arrin t'i shmanget disa pasaktësive. Kështu, ajo vendndodhjen e arbërve të mirëfilltë e zhvendos më në jug, në malësinë e Kurveleshit. Tjetër gabim në të cilin ka rënë studiuesja Rosi është edhe pranimi prej saj i tezës së historiografisë serbe të kolonizimit të Kosovës prej shqiptarëve më 1690. Po ashtu njëanshmëria e Rosi-t, e cila rrëshqet edhe në pozita nacionaliste, bie në sy në trajtimin e Luftës së Vlorës, të cilën ajo e cek vetëm shkarazi. Kështu sulmet e labëve mbi garnizonet italiane në prapatokën e Vlorës, ajo i emërton si sulme kusarësh të

armatosur mirë (...le bande di grassatori, bene armati...) dhe trupat e parregullta shqiptare që sulmuan në qershor të vitit 1920 garnizonin pushtues që mbante të pushtuar Vlorën, studiuesja i emërton si kryengritës.

Si përfundim mund të themi se ky libër, pavarësisht disa të metave që sapo i përmendëm më sipër, është një punim i arritur. Ai përfaqëson një mënyrë shumë origjinale dhe me vlerë të paraqitjes së historisë, ku ajo shfaqet nëpërmjet fotografive. Janë të shumta rastet kur këto të fundit, pavarësisht se nuk flasin, të japin një informacion mjaft të pasur historik e në mjaft raste me të njëjtën vlerë sikurse edhe burimet e shkruara. Le të shpresojmë që ky libër të përkthehet sa më parë, në mënyrë që t'i ofrohet në shqip lexuesit, studiuesit dhe studentit shqiptar.

Artan HOXHA

